



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:036245

Datë: 22.03.2024

Numri i dokumentit: 05489857

Ac.nr.2167/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Naime Ahmeti, kryetare e kolegjit, Burim Shala dhe Ardian Ajvazi, anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Kompania e Sigurimeve “E.....” sh.a, me seli në Prishtinë, kundër të paditurit S.K., nga Prishtina, me bazë juridike rimbursim dëmi, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga ana e paditëses, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2877/2017, të datës 29.05.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 21.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Aprovohet e themeltë ankesa e paditëses Kompania e Sigurimeve “E.....” sh.a, me seli në Prishtinë, **anulohet** aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2877/2017, i datës 29.05.2018, dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në procedim të serishëm.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin ankimor C.nr.2877/17, të datës 29.05.2018 në, dispozitiv të aktvendimit e ka konsideruar të tërhequr padinë me numër C.nr.2877/2017 të datës 26.10.2017, e palës paditëses Kompania e Sigurimeve “E.....” sh.a, nga Prishtinë, kundër të paditurit S.K., nga Prishtina, për pagesën e borxhit bazuar në të drejtën në regres.

Kundër këtij aktvendimi, brenda afatit të paraparë ligjor ankesë ka parashtruar paditësja, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, të prish aktvendimin e e atakuar dhe çështja të kthehet në procedim të serishëm në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, ka gjetur se:

- **Ankesa është e themeltë**

Nga shkresat e lëndës, rezulton se paditësja ka parashtruar padi pranë gjykatës së shkallës së parë, kundër të paditurit për rimbursim dëmi. Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin C.nr.2877/17 të datës 21.08.2018, i ka kthyer paditëses në plotësim padinë që në afat prej 3 ditësh, të siguroj adresën e saktë të paditurit në kundërtën do të veprohet konform nenit 102 të LPK-së. Paditësja, duke vepruar konform aktvendimit të gjykatës, me parashtresën e datës 06.03.2018, ka bërë rregullimin e padisë në aspektin subjektiv në raport me emrin, mbiemrin dhe adresën e të paditurit. Gjykata e shkallës së parë duke mos vepruar sipas rregullimit të padisë nga ana e paditëses, vendosi si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e Apelit, vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1, lidhur me nenin 102, paragrafi 3 të LPK-së.

Kolegji i Gjykatës së Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë duke vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar gabimisht ka zbatuar dispozitën e nenit 102, paragrafi 3 të LPK-së, ku përcaktohet se: “*Do të konsiderohet se është tërhequr parashtresa po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtresa do të hidhet poshtë*”. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë është dashur që me rastin e vendosjes të zbatoj në mënyrë të drejtë dispozitën e lartcekur dhe se nuk ka mundur që të konsideroj të tërhequr padinë siç edhe ka vepruar, pasi që pasi që paditësja me parashtresën e datës 06.03.2018, ka bërë rregullimin e padisë në afatin e caktuar, me adresën e cila është cekur në Raportin e policisë të aksidentit të datës 05.07.2015 dhe adresë tjetër nuk ka disponuar, ndërsa gjykata ka pasur për obligim që sipas detyrës zyrtare t’ia caktoj përfaqësuesin e përkohshëm të paditurit S.K., nga Prishtina, të cilit tani më nuk i dihet adresa e saktë, duke vepruar në pajtim me dispozitën e nenit 79 par.3, pika (a) të LPK-së, dhe pastaj ta obligoj paditësin ashtu siç parashihet me dispozitën e nenit 81 par.2 të të njëjtit ligj, në deponimin e të hollave për pagimin e shpenzimeve të përfaqësuesit të përkohshëm, nën kërcënim të pasojave ligjore, konform nenit 102.3 të LPK-së, dhe nëse paditësi nuk vepron sipas kësaj dispozite tek atëherë ka mundur të ndërmarrë veprimin për ta konsideruar të tërhequr padinë e paditësit. Andaj, nga këto arsye është dashur që aktvendimi i atakuar të anulohet dhe çështja ti kthehet të njëjtës gjykatë në procedim të serishëm.

Në ri procedurë gjykata e shkallës së parë duhet të ketë parasysh vërejtjet e cituara me lartë, të veprojnë sipas dispozitave të lartë cituara, duke ndërmarrë veprimet e duhura, e pastaj të vazhdojnë procedurën konform dispozitave ligjore duke marrë aktvendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Numri i lëndës: 2021:036245
Datë: 22.03.2024
Numri i dokumentit: 05489857

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 208 dhe 209, pika d), të LPK-së.

GJYKATA E AELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.2167/2023, më datë 21.03.2024

Kryetare e kolegjit
Naime Ahmeti, d.v.